

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 10 shtator 2020**

Mbledhja është mbajtur në objektin e Qendrës Rinore në Vushtrri, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris: Abdullah Vojvoda, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Safet Idrizi, Suzana Sylja Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Gentiana Rama, Hysni Gërguri, Agim Bregaj, Fitim Halili, Melihate Basholli-Latifi, Selim Rustemi, Shkëlzen Feka, dhe Shpëtim Zhegrova.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 27 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtor të drejtorive komunale dhe zyrtarë tjerë kompetent komunal.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit- pasi hapi mbledhjen tha se uroj që të tejkalohet kriza nga pandemia që e ka përfshirë globin në tërësi. Tutej prezanto se në pikën në të ndryshme është proceduar edhe një pikë tjetër e cila ka të bëjë me ndarjen apo transferimin e mjeteve financiare të komunës. Tutje ai duke ju referuar Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit njoftoi se ky akt e përjashton mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të rendit të ditës në mbledhjet e jashtëzakonshme. Por ai vlerësoi se neni 44 paragrafi 3 i LVL-së përcakton se pikat e rendit të ditës nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se më herët nuk ka pasur bashkëngjitje të një pike shtesë në rend të ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme pasi një gjë e tillë është e ndaluar decidivisht me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por sido që të jetë ai kërkoi opinionin e zyrës ligjore të Komunës se a kemi të drejtë të vendosim një gjë të tillë. Për kundër kësaj si grup kuvendar janë të pajtimit për procedimin e këtij rendi të ditës, por ka dilema që mund të kthen si të kundërligjshme të gjitha këto pika të përcaktuara në rend të ditës. Ai vlerësoi se për pikën e tretë të rendit të ditës nuk është

dërguar materiali sipas afateve ligjore dhe kjo e bënë jo të ligjshme marrjen e një vendimi të tillë. Pavarësisht këtyre është dashur zyra ligjore të adresoj me shkresë të drejtën e kuvendit për ta vendosur këtë pikë shtesë në rend të ditës.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit-saktësoj se edhe më herët ka pasur shtim të pikave në mbledhje të jashtëzakonshme, po që këtë gjë e ka kërkuar natyra urgjente e atyre pikave. Ai vlerëson se një praktik e tillë e dërgimit të pikave të rendit të ditës nuk është e mirë por se natyra e çështjes që ka të bëjë me transferimin e mjeteve financiare kërkon që të procedojmë më tej. Tutje ai lexoj para kuvendit nenin 44 të LVL-së ku thuhet: *Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes*. Në këtë kontekst sqaroi se ne akoma nuk e kemi aprovuar rendin e ditës dhe një gjë e tillë mund ta procedojmë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi se jo për ta arsyetuar Zyrën Ligjore, por ata zyrtar janë vërtet shumë të zënë me punë dhe nuk kanë mundur të jenë prezent në mbledhje të kuvendit. Tek pika që është propozuar nga ZKF-ja, kemi të bëjmë me mbulimin e shpenzimeve për pagat jubilarë të mësimdhënësve ashtu që të aprovohen sot, ashtu që të kemi mundësi që këto mjetet të ekzekutojmë ashtu që të shmangen procedurat gjyqësore dhe mënjanimin e shpenzimeve tjera për komunën. Ligji nuk ja mohon të drejtën kuvendit që të shtohen pika tjera në rend të ditës, por që ndalon ndryshimin e pikave të rendit të ditës. Në këtë frymë MAPL, nuk i kishte deklaruar si kundërligjore vendimet e mbledhjes së muajit prill, ai pajtohet se një praktik e tillë nuk është e mirë, por që këtë vit gjendja me covid-19 vërtet ka shkaktuar çrregullime të mëdha dhe edhe ndryshime radikale buxhetore. Andaj ai kërkoi mbështetjen e kuvendit për procedimin e rendit të ditës, ashtu që të mundësohet marrja e këtyre vendimeve për mbulimin e shpenzimeve të mësimdhënësve dhe ruajtjen e buxhetit.

Pas debateve Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 26 vota “për” dhe një anëtar i kuvendit që nuk mori pjesë në votim aprovoi këtë

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për rialokimin- transferin e mjeteve financiare të komunës;
2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lirim nga pagesa e tarifës për çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtri.
3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për rialokimin-transferin e mjeteve financiare të komunës nga kategoria e pagave dhe mëditjeve;

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për rialokimin- transferin e mjeteve financiare të komunës;

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin në fjalë i cili kërkoi që bëhen ndryshime sa i përket vendosje së kodeve ekonomike dhe kodeve të programeve. Ai njoftoi se është kërkesë e analistit të buxhetit që përshkrimi i programit të jetë para kodit ekonomik, ai arsyetoi se ky është një ndryshim teknik i cili nuk ndryshon asgjë në përmbajtje të propozim-vendimit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime bëhet si në vijim:

1.1 Nga programet:

- 1.1.1. Arsimi parafillor (92670), shuma prej.....561.29 €
- 1.1.2. Arsimi i mesëm (94890),shuma prej.....24,438.71 €

1.2. Transferohen në programin:

1.2.1. Infrastruktura publike (180) nen-programi (18184) në shumën 25,000.00 € (fondi i Covidit 00099).

2. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në mallra dhe shërbime.

2.1 Nga programi

- 2.1.1. Arsimi fillor (93690) shuma prej.....336,961.79 €

2.2.Transferohen në programin

2.2.1.Administrata (920) nen-programin (92120),shuma prej 336,961.79 €

3. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva ne subvencione.

3.1 Nga programet:

- 3.1.1. Zyra e kryetarit (16024) shuma prej.....1,491.00 €
- 3.1.2. Administrata (16324) shuma prej.....3,285.00 €
- 3.1.3.Çështjet gjinore (16524) shuma prej.....1,414.00 €
- 3.1.4 Inspekcioni (16647) shuma prej.....4,709.00 €
- 3.1.5.Prokurimi (16820) shuma prej.....3,858.00 €
- 3.1.6.Zyra e K.K (16924) shuma prej.....9,087.00 €
- 3.1.7.Buxheti (17524) shuma prej.....496.00 €
- 3.1.8.Infrastruktura publike (18184) shuma prej.....9,199.00 €
- 3.1.9.Menaxhimi i fatkeqësive natyrore (18468) shuma prej.....3,115.00 €
- 3.1.10.ZLK (19620) shuma prej.....5,041.00 €
- 3.1.11.Bujqësia (47024) shuma prej.....17,960.00 €
- 3.1.12.Shërbimet kadastrale (65120) shuma prej.....4,078.19 €
- 3.1.13.Planifikimi urban (66425) shuma prej.....10,878.00 €
- 3.1.14.Shërbimet kulturore (85024) shuma prej.....19,794.10 €
- 3.1.15.Arsimi parafillor (92670) shuma prej.....15,594.71 €

3.2. Transferohen në programin

3.2.1. Shëndetësi (730) nen-programin (74450), shuma **110,000.00 €**

4. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në subvencione.

4.1. Nga programi: Arsimi i mesëm (94894) shuma prej.....110,000.00 €

4.2. Transferohen në programin Zyra e kryetarit (160) nën-programin (16024), shuma prej.....110,000.00 €.

5. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në investime kapitale.

5.1 Nga programi

5.1.1. Arsimi i mesëm (94890) shuma prej.....63,475.29 €

5.1.2. Administrata(92120) shuma prej.....9,938.00 €

5.1.3. Arsimi fillor (93690) shuma prej.....26,586.71 €

5.2. Transferohen në programin

5.2.1. Infrastruktura publike (180) nen-programin 18184 në shumën 100,000.00 € ne projektin Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit “kodi (46628) shuma prej.....100,000.00 €.

6. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në investime kapitale.

6.1. Nga programi:

6.1.1. Arsimi fillor (93690) shuma prej.....40,000.00 €.

6.2. Transferohen në programin:

6.2.1. Infrastruktura publike(180)nen-programin (18184) në shumën 40,000.00€ projekti „ Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse “ kodit (47976) në shumën 40,000.00€.

7. Transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në investime kapitale.

7.1. Nga programi

7.1.1. Arsimi fillor (93690) shuma prej.....20,000.00 €.

7.2. Transferohen në programin

7.2.1. Infrastruktura publike(180) nen-programin (18184) shuma prej 20,000.00 € në projektin „ Rrugët e rendit të katërt” kodit (90226) shuma prej.....20,000.00 €.

- 1.1.9. Bujqësia, me kod të programit 47024, shuma.....(12,000.00€)
1.1.10. Shërbimet kadastrale, me kod të programit 65120, shuma...(12,000.00€)
1.1.11. Planifikimi urbanizmi dhe inspeksioni, me kod të programit 66425, shuma.....(9,000.00€)
1.1.12. Shërbimet kulturore, me kod të programit 85024, shuma....(15,000.00€)

1.2 Shuma e mjeteve financiare të cekura në paragrafin 1.1 të këtij vendimi rialokohen-transferohen në programin shërbimi i kujdesit primar shëndetësor, me kod të programit 74450, shuma.....105,000.00 €

2. Nga programi:

2.1 Arsimi i mesëm, me kod 94890, shuma.....(50,000.00 €)


2.2. Në programin Arsimi fillor, me kod 93690, shuma.....(50,000.00 €)

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale si dhe Drejtoria e Arsimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:27.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

